

Përgjigje e Ankesës ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një asistenti-doktorant për lëndët mësimore në fushën e së drejtës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës

Ankesa ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018 u shqyrtua me kujdes nga anëtarët e Komisionit recensues në përbërje: **Prof. Dr. Agim Nuhiu - kryetar, Prof. Dr. Bashkim Selmani - anëtar dhe Doc. Dr. Afet Mamuti, anëtar.** Komisioni në fjalë e jep këtë Përgjigje në formë të raportit tekstual:

Ankesa e dorëzuar nga kandidati Mr. sc Nail Isufi nuk i plotëson elementet e duhura të Kundërshtimit, i cili parashihet në nenin 79 dhe 80 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore- shkencore, shkencore, mësimore – profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistentëve- doktorantë në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 të datës 12.06.2014. Kjo për disa arsye:

1. Kandidati nuk ka të drejtë Ankese ndaj referatit të Komisionit recensues, por ka të drejtë Kundërshtimi. Komisionit recensues nuk sjell vendim por jep Propozim, prandaj në pajtim me nenin 79 të Rregullores së cituar më lart, kandidati do të duhej të dorëzojë Kundërshtim ndaj referatit e jo Ankesë.

2. Kandidati Mr. sc Nail Isufi nuk e plotëson kushtin që është kërkuar nga Konkursi për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës - Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë vazhdimësi në studimet nga fusha përkatëse, që nënkupton vazhdimësi në mbajtjen e ushtrimeve, respektivisht dëshmi se ka qenë i angazhuar si asistent vite me radhë.

3. Kandidati Mr. sc Nail Isufi nuk ka përvojë universitare, gjegjësisht kandidati nuk ka dorëzuar Kontratë se ka qenë i angazhuar si staf akademik në ndonjë universitet e aq më pak në Universitetin e Tetovës.

4. Komisioni recensues, pas rishqyrtimit të shtojcës tabelare konstaton se vlersimi me pikë i veprimtarisë mësimore –shkencore dhe veprimtarive tjera është kryer në përputhshmëri me Kriteret për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje në thirrjet mësimore që janë pjesë përbërëse e Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, shkencore, mësimore-profesionale, të bashkëpunëtorëve dhe të asistentëve - doktorantë në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 të datës 12.06.2014. dhe kandidati i propozuar për zgjedhjen asistent-doktorant Dr.sc Fisnike Bekteshi Shaqiri i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur asistent-doktorant për lëndët mësimore në fushën e së drejtës.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga të gjithë kandidatët për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, të datës 30.01.2018, Komisioni recensues ka vlerësuar se:

-Kandidati **Doktor i shkencave juridike, Dr. sc. Fisnike Bekteshi - Shaqiri** i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen asistent-doktorant në fushën e së drejtës, duke u referuar në përvojën e deritanishme profesionale dhe pedagogjike. Kandidati Doktor i shkencave juridike, Fisnike Bekteshi- Shaqiri, i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur asistent-doktorant në fushën e së drejtës.

-Komisioni recensues ka konstatuar se Doktor i shkencave juridike, Fisnike Bekteshi-Shaqiri, është e angazhuar si asistente në Fakultetin Juridik që nga viti 2010 dhe me sukses ka kryer veprimtari mësimore në fushën e së drejtës dhe ka përparësi ndaj kandidatëve tjerë, të cilët nuk kanë të lidhur marrëdhënie pune në ndonjë universitet. Po ashtu kandidati Fisnike Bekteshi-Shaqiri ka thirrjen shkencore Doktor i shkencave juridike, e cila i jep përparësi kundrejt kandidatëve tjerë.

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Nga e gjithë kjo që u tha më lart, Komisioni recensues konsideron se Ankesa e kandidatit Mr. sc Nail Isufi, nr.02-2167/1 e datës 17.05.2018 është e pabazë.

Komisioni recensues në përbërje të: **Prof. Dr. Agim Nuhiu - kryetar, Prof. Dr. Bashkim Selmani- anëtar dhe Doc. Dr. Afet Mamuti - anëtar**, ka nderin e veçantë që edhe njëherë t'i propozojë Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Doktori i shkencave juridike, Fisnike Bektashi-Shaqiri**, të zgjidhet asistent-doktorant në fushën e së drejtës.

Tetovë, më 18.05.2018

Komisioni recensues:

1. **Prof. Dr. Agim Nuhiu (kryetar)**

2. **Prof. Dr. Bashkim Selmani (anëtar)**

3. **Doc. Dr. Afet Mamuti (anëtar)**
